



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 01 Maj 2021

Nr: 328

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË
PËRGJITHSHME PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. ARTUR ISMAIL BAKU,
KANDIDAT PËR DEPUTET I SUBJEKTIT ZGJEDHOR PARTIA LËVIZJA
SOCIALISTE PËR INTEGRIM, QARKU DURRËS, NË ZBATIM TË LIGJIT
NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN,
EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të pikës 12, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 2685/4 prot., datë 16.04.2021, me lëndë “Dërgohet Vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit” për subjektin vetëdeklarues z. Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës

VËREJ:

I.

- Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
- Kandidatët për deputet dhe në organet e qeverisjes vendore.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", z. Artur Ismail Baku, si kandidat i listës shumëmemërore të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Durrës, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër 549 unik.

- i. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2023 prot., datë 15.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe me shkresën nr. 1825 prot., datë 09.03.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile.
- ii. Me shkresën nr. 2729/1 prot., datë 16.03.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet, z. Artur Ismail Baku, nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë në sistem, pra nuk është i dënuar.
- iii. Me shkresën nr. 986/1 prot. dhe 1030/1 prot., datë 08.04.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet z. Artur Afrim Baku, sipas procesverbalit nr. 31 datë 06.09.2005 ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga "Afrim" në "Artur".
- iv. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me Vendimin nr. 147 datë 16.03.2021, vendosi "Miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, për zonat zgjedhore, Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Qarku Fier, Qarku Gjirokastrë, Qarku Korçë, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë".

II.

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Artur Ismail Baku.



Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Artur Ismail Baku, rezultojnë se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të formularit të vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitetet e tij dhe është shprehur se ka ndryshuar emrin nga “Afrim” në “Artur”.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pyetjes 4, “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një veprë penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Është proceduar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, për procedimin penal nr. 607, datë 24.11.2015, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, në vitin 2015, rezultat i së cilës është pushim i procedimit penal nr. 607, datë 24.11.2015, për veprën penale “Shpërdorim detyre”.

Pyetjes 5, “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Është caktuar masë shtrënguese e sigurisë, arrest në shtëpi, masë e cila është revokuar sipas:

- Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, për veprën penale “Shpërdorim detyrë, parashikuar nga neni 2448 i Kodit Penal, më datë 24.11.2015, për të cilën është vendosur pushim i procedimit penal nr. 607 datë 24.11.2015, për veprën “Shpërdorim detyrë”.
- Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, ka caktuar masë sigurimi personale “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal, më datë 24.11.2015, për të cilin është vendosur shuarje e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”.

Pyetjes 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se: Në vitin 1992 deri 1997, ka jetuar në Katerini, Greqi, për arsye emigracioni.

b.Referuar deklaramëve të bëra në formularin e vetëdeklarimit si dhe përgjigjes të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve , ku deklarohet se z. Artur Ismail Baku nuk ka



të dhëna në sistem por subjekti vetëdeklarues deklaroi në formularin e vetëdeklarimit se ka një vendim gjyqësor jo të formës së prerë si dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2683 prot., datë 25.03.2021 vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

c. Me shkresën nr. 2685/4 prot., datë 16.04.2021, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin e rezultatit të verifikimit për subjektin vetëdeklarues z. Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës.

d. Sipas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme “Për miratimin e rezultatit të verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 për subjektin Artur Ismail Baku”, administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 2685/4 prot., datë 16.04.2021, rezultoni se Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar institucioneve si më poshtë vijon për verifikim të mëtejshëm:

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 3442/1 prot., datë 01.04.2021 ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme dokumentin “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 11 prot., datë 01.04.2021. Nga ky dokument informohemi se shtetasi Artur (Afrim) Baku, i biri i Ismail dhe Hajrie, lindur më datë 17.12.1973, në Luz (Krujë), është i Padënuar.
- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 1374/1 prot., datë 07.04.2021, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të subjektit Artur Baku, sipas Regjistrisë Kombëtare të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave konstatohet se subjekti Artur Baku, me atësi Ismail dhe amësi Hajrie, lindur në Luz, Krujë, në datë 17.12.1973, me numër personal H31217058S, figuron i regjistruar banor në zyrën e gjendjes civile, në Njësinë Administrative Fushë-Krujë, bashkia Krujë.



Konstatohet se me procesverbalin nr. 32, datë 06.09.2005 ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile rubrikën e emrit nga “Afrim” në “Artur”, ndryshim i cili është pasqyruar në regjistrin themeltar të popullsisë të vitit 1974, “Qytet Fushë-Krujë”, referencë 21/85. Bashkëlidhur kanë vënë në dispozicion fletën e regjistrit themeltar të popullsisë të vitit 1974, ku është pasqyruar ndryshimi i kryer.

- Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, rezulton se subjekti Artur (Afrim) Baku:
 - ka ato gjenealitete, të cilat i ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe që janë konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
 - në sistem rezulton se në datë 21.11.2015, është shpallur në kërkim për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal;
 - në sistem, në datë 26.08.2015 rezulton se ndaj tij ka filluar procedimi penal në gjendje të lirë, pasi nuk i është bindur urdhrin të punonjësit të policisë, për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal;
 - nuk figuron si person i dëbuar nga territori i një shteti tjetër apo që të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar në ngarkim të tij;
 - nuk figuron asnjë person i regjistruar me të dhënat Afrim Ismail Baku.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti i Policisë Kriminale, me shkresën nr. 6243/2 prot., datë 06.04.2021, na informon se:
 - nga të dhënat e grumbulluara në sistemin elektronik, subjekti **z. Artur Ismail BAKU**, lindur në datë 17.12.1973, është arrestuar në datë 23.11.2015 nga strukturat e policisë të stacionit të policisë Fushë-Krujë, në Komisaratin e Policisë Krujë, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi duke qenë me detyrë Drejtor Rajonal i Shërbimit Pyjor të Qarkut Durrës, pas bllokimit të lëndëve drusore që transportoheshin pa dokumenta, bënte shitjen e tyre tek persona të ndryshëm pa pasur liçensë dhe kasë fiskale (për këtë veprë është shpallur në kërkim në datë 22.11.2015). Në datë 25.11.2015, është liruar pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, ka caktuar masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”.
 - nuk ka të regjistruara gjenealitete të tjera, përveç se ka deklaruar;
 - nga verifikimi i kryer në arkivën elektronike të ZQK Interpol Tirana, ka rezultuar se për këtë shtetas nuk disponohen të dhëna nëse është në kërkim ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i huaj.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, me shkresën nr. 189/3 prot., datë 15.04.2021, lidhur me subjektin Artur (Afrim) Baku, na informon se pas verifikimeve të kryera, rezulton se kjo Prokurori:

- ka regjistruar fillimisht kallëzimin penal nr. 559, datë 27.08.2015 e më pas procedimin penal nr. 457/2015, në ngarkim të tij, për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal. Ky procedim është pushuar në datë 06.01.2016. Bashkëlidhur kanë vënë në dispozicion kopjen të njëhsuar me origjinalin të fashikullit të procedimit penal.
- ka regjistruar fillimisht kallëzimin penal nr. 763, datë 23.11.2015 e më pas procedimin penal nr. 607/2015. Ky procedim është pushuar në datë 23.03.2016. Bashkëlidhur kanë vënë në dispozicion kopjen të njëhsuar me origjinalin të fashikullit të procedimit penal.

Referuar materialeve rezulton se me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal nr. 607/2015, kjo prokurori pas regjistrimit të procedimit penal për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ka regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale, shtetasin Artur Baku, lindur në datë 17.02.1973.

Referuar procesverbalit “për arrestimin në flagrancë”, datë 23.11.2015, shtetasi Artur Baku është “arrestuar në flagrancë”, për shkak të detyrës si Drejtor i Shërbimit Pyjor i Qarkut Durrës.

Referuar vendimit të pushimit të procedimit penal të datës 23.03.2016, rezulton se prokuroria ka vendosur: pushimin e procedimit penal nr. 607, datë 24.11.2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal ndaj personit nën hetim shtetasit Artur Baku; shuarjen e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale për personin në hetim Artur Baku.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me shkresën nr. 337 prot., datë 09.04.2021, pas verifikimeve të kryera, ka vënë në dispozicion kopje të njëhsuar me origjinalin të vendimit penal nr. 337, datë 25.11.2015 dhe nr.69, datë 09.03.2016, në ngarkim të shtetasit Artur Baku. Në emër të shtetasit Afrim Baku nuk ka asnjë vendim penal apo vendim për masa sigurimi në këtë gjykatë.

Referuar vendimit nr. 337, datë 25.11.2015, gjykata pas kërkesës së prokurorit ndaj shtetasit Artur Baku për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, ka vendosur: vleftësimin si të ligjshëm të “Arrestimit në flagrancë” të shtetasit Artur Baku dhe caktimin e masës së sigurimit personal atë të “Arrestit në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, duke urdhëruar lirimin e tij.

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Durrës, në zbatim të ligjit nr. 138/2015

Data: 01 Maj 2021
Nr. 328



Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë dhe Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 1876, datë 17.12.2015, ka vendosur miratimin e vendimit penal (masë sigurimi), nr. 337, datë 25.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka paraqitur rekurs i gjykuari Artur Baku dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 67, datë 28.01.2016, ka vendosur: Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari Artur Baku kundër vendimit nr. 1876, datë 17.12.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Referuar vendimit nr. 69, datë 09.03.2016, rezultoi se Gjykata, pas kërkesës së shtetasit Artur Baku për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në shtëpi” në “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ka vendosur: rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Artur Baku si të pambështetur në prova e në ligj.

Nga informacioni i përcjellë nga Prokuroritë e tjera pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, Gjykatave t
ë

A
Prokuroria e Përgjithshme në shkresën e saj referon se, në mungesë të indicieve apo të dhënave që
p
do të justifikonin një verifikim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe pas kryerjes së
e
gjithë verifikimeve të mundshme brenda vendit, i konsideron këto verifikime të plota, bazuar në
l
përcaktimet e nenit 8, pika 1,2 të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e
l
integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në
t
përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10,11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr.
17/2016.

d

h

e

III.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të Verifikimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se:

r Subjekti vetëdeklarues z. Artur Afrim Baku ka plotësuar Rubrikën B si dhe pikat 4, 5 dhe 8 të formularit të vetëdeklarimit.

k

u

r

o

r

i

a

- në përgjigje zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, konstatohet se subjekti deklarues ashtu siç dhe e ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit ka kryer ndryshime në përbërësin e gjendjes civile, në rubrikën e emrit nga

Data: 01 Maj 2021
Nr. 328

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Durrës, në zbatim të ligjit nr. 138/2015



“Afrim” në “Artur”, ndryshim i cili është pasqyruar në regjistrin themeltar të popullsisë të vitit 1974, “Qytet Fushë Krujë”, referencë 21/85.

- Nuk rezultoi i dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e ndonjë vepre penale nga autoritetet gjyqësore shqiptare;
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezultoi të ketë qenë i ndaluar/arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare për kryerjen e një vepre penale:
 - a. Referuar përgjigjes zyrtare të Policisë së Shtetit, subjekti Artur Baku, në datë 23.11.2015 është arrestuar nga strukturat e policisë të stacionit të policisë Fushë Krujë, në komisariatit e policisë Krujë, për veprën penale “Shpërdorim Detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Më datë 25.11.2015 është liruar pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në shtëpi”.
 - Rezultoi të ketë qenë i siguruar më masë shtrënguese të sigurisë personale:
 - a. Referuar vendimit nr. 337, datë 25.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, pas kërkesës së Prokurorit për vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj z. Artur Baku për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim Detyre”, ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit Artur Baku dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.P, duke urdhëruar lirin e tij.
 - b. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë dhe Gjykata e Apelit me vendimin nr. 1876, datë 17.12.2015 e cila ka vendosur miratimin e vendimit penal (masë sigurimi) nr. 337, datë 25.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.
 - c. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tirane, ka paraqitur rekurs i gjykuarai Artur Baku dhe Gjykata e Lartë, nr. 67 datë 28.01.2016 e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari Artur Baku kundër vendimit nr. 1876 datë 17.12.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Referuar deklarimeve të bëra në formularin e vetëdeklarimit, përgjigjes të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, vendimit për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin z. Artur Afrim Baku, vepra penale “Shpërdorim Detyre” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal,

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Durrës, në zbatim të ligjit nr. 138/2015

Data: 01 Maj 2021
Nr. 328



përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në të cilin parashikohet se: ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave për **b) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në Kreun X "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve", të Kodit Penal.**

Ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4, pika 2 të ligjit të sipërcituar, "*Për personat që parashikohen nga shkronja "b", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 20 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë*".

Në kushtet kur nuk ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, pasi subjektit deklarues z. Artur Afrim Baku, vetëm është arrestuar nga strukturat e policisë Fushë Krujë dhe më datë 25.11.2015 është liruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, duke u caktuar masa e sigurimit "Arrest në shtëpi", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, kandidati për deputet i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës, z. Artur Afrim Baku nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pika 12 e Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"



Data: 01 Maj 2021
Nr. 328

Për shqyrtimin e rezulttit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Durrës, në zbatim të ligjit nr. 138/2015

V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
I.Osmanaj _____
B.Kodra _____
M.Koja _____
A.Lamçe _____
Y.Merkaj _____

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021



Data: 01 Maj 2021
Nr. 328

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Artur Ismail Baku, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Durrës, në zbatim të ligjit nr. 138/2015